



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit



01 Nr 020/04 13889 dt. 21.03 2023

Në vështrim të nenit 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72, të Statutit të Komunës së Drenasit, Procedurat Standarde të Trajtimin të Rekomandimeve, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

## V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues

- I. Caktohet Grupi Punues për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021, në këtë përbërje:
  1. Arianit Bala, kryesues,
  2. Agim Kastrati, anëtar,
  3. Drilon Morina, anëtar,
  4. Armend Cakiqi, anëtar,
  5. Granit Karaqica, anëtar,
  6. Meridon Demaj, anëtar.
- II. Detyrat e Kryesuesit janë: 1. Përgatit planin kohor për komentim; 2. Organizon mbledhjen e komenteve dhe të evidencave nga anëtarët e GP; 3. Përcjell tek koordinatori procesin, komentet dhe evidencat e grumbulluara nga GP; 4. Përpilon Draft PV për zbatimin e rekomandimeve dhe e dorëzon tek koordinatori i procesit; 5. Te Koordinatori i procesit dorëzon evidencat për rekomandimet e zbatuara dhe ato në proces.
- III. Detyrat e Grupit Punues janë: 1. Analizojnë draft raportin e auditimit, të gjeturat dhe rekomandimet për fushat përkatëse; 2. Përcjellin komentet dhe dëshmitë të kryesuesi i Grupit punues për fushat përkatëse; 3. Shqyrtojnë raportin final dhe vërtetojnë integritimin e komenteve të bazuara në fakte.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i komunës dhe Drejtoratet përkatëse.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të komunës.

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Anëtarëve të Grupi Punues;
- Të gjitha drejtorive;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci